

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nervozizmi kushton! Këta janë tenistët që lanë mijëra dollarë gjoba në “US Open” – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/nervozizmi-kushton-keta-jane-tenistet-qe-lane-mijera-dollare-gjoba-ne-us-open/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 08:50:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 08:46:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8ea151c584fb5a451f75b813866fee50d3356eb370b241a8956883dd4cf889a2
TEKSTI	1be951d1018dd88d6464df76cb3de985ec47eed96c708a4f3336fa574f9e6565
PAMJA	b5b4d1439fb47ec52d91e40338699e564a3b9348812c5c180f0645eb03e88651

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	654251b0dba348f2b2566bd3847299575eb19c4103b0d0b36e2ce618849b898e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	479381fa2a49a22c779ba6938b50ec298f3d05b6f6a0c36ab6b39ef80d1b34ab
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/654251b0dba348f2b2566bd3847299575eb19c4103b0d0b36e2ce618849b898e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



US Open 2026 nuk prodhoi vetëm spektakel në tushë, por edhe një taturë të konsiderueshme në gjoba. Gjatë turneut në New York u regjistruan 20 shkelje të Kodit të Sjelljes së Grand Slam, me një total prej 112,500 dollarësh të zbritur nga shpërblimet e lojtarëve.

Në krye të listës qëndron argjentinassja Luisina Giovannini, e cila u gjobit me 20,000 dollarë pas ndeshjes së saj në raundin e parë të kualifikimeve. Giovannini u tërhoq pas vetëm 17 minutash, kur ishte në disavantazh 0-5 ndaj italianes Lucia Bronzetti. Ajo kishte fituar vetëm tetë nga 29 pikët e zhvilluara. Gjoba u vendos në bazë të rregullit për performancën në raundin e parë, i cili parashikon masa disiplinore kur paraqitja nuk konsiderohet në nivelin profesional të kërkuar.

Pas saj renditet francezi Corentin Moutet, me një total prej 15,000 dollarësh. Ai mori dy gjoba në të njëjtën ditë: 5,000 dollarë për dëmtim të raketës ose pajisjeve dhe 10,000 dollarë për shkeljen e rregullave mbi veshjen dhe pajisjet.

Luciano Darderi grumbulloi 10,000 dollarë gjoba nga dy shkelje të ndryshme. Njëra ishte për abuzim me raketën ose pajisjet, ndërsa tjetra për një obcenitet të dëgjueshëm.

Në listën e gjobave të larta është edhe francezi Terence Atmane, i cili u ndëshkua me 7,500 dollarë për abuzim verbal. Incidenti ndodhi gjatë ndeshjes së tij ndaj Jaume Munar dhe përfshiu një përplasje me personelin mjekësor të turneut.

Të njëjtën shumë, 7,500 dollarë, e mori edhe Jaime Faria, por për një arsye

horoskopit që do të kenë një javë të...

5 Horoskopi sot/ Yjet paralajmërojnë ndryshime, kush do të ketë fat në...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

tjetër: portugezi u ndëshkua për përdorim të shprehjeve vulgare të dëgjueshme gjatë humbjes së tij ndaj Carlos Alcaraz.

Raketat ishin ndër shkaqet më të zakonshme të gjobave në Flushing Meadows. Arthur Fils u gjobit me 5,000 dollarë, ndërsa Arthur Gea, Sebastian Ofner, Otto Virtanen dhe Vilius Gaubas me nga 2,500 dollarë për shkelje të lidhura me dëmtimin ose keqpërdorimin e raketave dhe pajisjeve. Dalibor Svrčina dhe Francisco Cerundolo morën gjithashtu nga 5,000 dollarë për të njëjtën kategori shkeljeje.

Një prej emrave më të njohur në listë është edhe Aryna Sabalenka. Bjellorusja u gjobit me 7,500 dollarë pasi, pas humbjes në finalen e US Open ndaj Elena Rybakina, theu raketën në fushë në shenjë zhgënjimi.

Në listë është edhe Belinda Bencic, e cila u gjobit me 5,000 dollarë për sjellje antisportive. Ndërkohë, lista përfshin edhe raste të tjera si obcenitete të dëgjueshme dhe komunikim të palejuar me trajnerin gjatë ndeshjes.

Në total, gjobat tregojnë se gjatë edicionit të këtij viti shkeljet nuk u kufizuan vetëm te shpërthimet e nervave: ato përfshinë dëmtimin e pajisjeve, sjelljen antisportive, abuzimin verbal, veshjen dhe madje edhe standardet e performancës në rundet kualifikuese.

US Open 2026 përfundoi kështu me 112,500 dollarë gjoba për 20 shkelje, krahas miliona dollarëve të shpërndarë në formën e çmimeve për lojtarët.

#UsOpen



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



SPORT

**Real Madrid fiton mes
vuajtjesh kundër...**

Xhuljana
Zhuleku Sot
01:42



SPORT

**(VIDEO) Ky është goli i
shënuar nga Anis...**

Xhuljana
Zhuleku Sot
01:37



SPORT

**Anis Mehmeti nuk
zhgënjën, i shënon...**

Xhuljana
Zhuleku Sot
00:27

Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

☐ Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

• LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.